



## **RAPORT AUDITIMI (TEMATIK)**

### **BASHKIA CËRRIK**

**(Auditim Financiar, pasqyrat financiare 2021)**

**Tiranë, 2022**

## PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4 - 8</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimití í í í í í í í í í í í í í í í í	4 – 4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveí í í í í í í í í í í í í í í í í	4 – 6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimití í í í í í í í í í í í í .	6 – 8
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8 – 12</b>
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i>	
	b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i>	
	c. <i>Identifikim i çështjes.....</i>	
	d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	f. <i>Kriteret e vlerësimit .....</i>	
	g. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	h. <i>Metodat e auditimi .....</i>	
	i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>12 - 31</b>
1.	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.</b>	<b>12 – 12</b>
2.	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.</b>	<b>12 - 31</b>
2.1	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 202</i>	<i>12 – 31</i>
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>31 – 32</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>32 – 36</b>

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontroli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave.
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve.
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 13.6.2022 deri në datë 23.6.2022, realizoi auditimin financiar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Cërrik, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në hartimin e pasqyrave financiare viti 2021.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Cërrik për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një opinion të ***pamodifikuar, me theksim çështjeje***, për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021).

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

### I.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport Auditimi	Rekomandimi
1	Nga auditimi konstatohet se gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,655,845 lekë, i pandryshuar. Për këtë gjendje llogarie të palëvizshme nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale. Gjendja e llog. 211 "Pyje, Plantacione", paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,692,300 lekë. Ndërsa sipas	I Lartë	12-31	Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit e aktiveve në llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe llog. 211 "Pyje, Plantacione", ku nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në PF e

	<p>Formatit nr.7/B <i>ōGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)</i>ō, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,692,300 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.</p> <p>Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikō i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 <i>ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeō Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.</i></i></p>			<p>në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>
2	<p>Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2021 është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim gjendje në fund të vitit 2021 janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.</p> <p>Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat si: <u>viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe</u></p>	I Lartë	12-31	<p>Drejtorja e Financës dhe Pronës Publike Bashkia Cërrik, të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.</p>

	<p><u>përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.</u></p> <p>Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.</p>			
3	<p>Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, rezulton se 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021, të cilat janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël të vitit 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujës-jellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuajduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò neni 6,9 dhe 10, Urdhrin e Ministrisë nr.64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 òAktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomaterialeò paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, pika òcò.</p>	I Lartë	12-31	<p>Drejtoria e Financës Bashkia Cërrrik, të marrë masa për sistemimin e llog. 202 òStudime e projekteò, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972 lekë. Të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.</p>

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Cërrrik, pavarësisht punës dhe përpjekjeve të mira menaxhuese, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një **“pamodifikuar, me theksim çështjeje<sup>1</sup>”**. Fushat kryesore në të cilat janë konstatuar gabime, janë në pasqyrimin jo të saktë të disa llogarive në pasqyrat financiare.

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinionit i pasqyrave financiare viti 2021:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Cërrrik për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dheshënime dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*“Sipas opinionit tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kuadrin rregullator për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.*

### **Baza për opinionin:**

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705<sup>2</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>3</sup>, pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi 5Theksimi i Çështjesö.

### **Theksimi çështjeje:**

**1. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** është nënvlerësuar për 5,989,972 lekë.

Për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021. Dhe janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël 2021 vlera 5,989,972 lekë.

**2. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim** gjendje në fund të vitit 2021 janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>3</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi

amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.

Llog 211 *ËPyje, Kullota, Plantacione*ö, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrrik dhe për 4 ish Komunat, sipas Formatit nr.7/B *ËGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ö në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e listës analitike, regjistrit të aktiveve për këtë llogari, nuk jep siguri se vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Cërrrik, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ö dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *ËPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ö, në zbatim të Projektit dhe Programit Tematik të Auditimit nr. 568, datë 14.6.2021 dhe Autorizimit nr. 568/2, datë 8.6.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 13.6.2022 deri në datën 23.6.2022, në subjektin Bashkia Cërrrik u krye auditimi *ËMbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2021*ö, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ**(Përgjegjës grupi).
2. **R. L.**

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe



parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Cërrik.

**a- Objekti i auditimit**, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

**b- Qëllimi i auditimit**, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)<sup>4</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

**c- Identifikimi i çështjes**: Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Cërrik, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

**d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**e- Përgjegjësitë e audituesve**.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të shpenzimeve operative dhe investimeve, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**f- Kriteret e vlerësimit**.

✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

---

<sup>4</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ōPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*.
- ✓ Rregullore e Brendshme *ōMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.
- ✓ Rregullore e Brendshme *ōMbi Procedurat e auditimit në KLSH*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020.
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar.
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Manualet e Auditimit Financiar të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ōPër financat e vetëqeverisjes Vendore*.
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 *ōPër procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, *ōPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006*.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.2.2022 *ōPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*.

#### **g- Standardet e auditimit:**

- ✓ ISSAI 100 *ōParimet themelore të auditimit të sektorit publik*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ✓ ISSAI 2000-2899 *ōUdhëzues të Auditimit Financiar*.
- ✓ ISSAI 2300 *ōPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*.
- ✓ INTOSAI GOV 9100 *ōUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*.
- ✓ INTOSAI GOV 9110 *ōUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme*.
- ✓ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI<sup>t</sup>, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

#### **h- Metodatat e auditimit:**

##### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

##### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 *ōMbi menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik*.

##### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushruar ekzaminonj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### 7. Intervistimi

#### 8. Raporte dhe Informacione

#### 9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

### **i-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.**

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>5</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

---

<sup>5</sup>Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

### **i- Dokumentimi i auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Auditimi në Bashkinë Cërrik u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në hartimin e pasqyrave financiare, *materiale dhe jo të përhapura*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime për çdo problematik të konstatuar, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Cërrik deri me datë 23.6.2022, datën e mbylljes së punës audituese në terren.

Nga subjekti Bashkia Cërrik nuk janë paraqitur kundërshti sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Auditimit të KLSH mbi problemet e konstatuara nga grupi i auditimit dhe të reflektuara në akt-konstatimeve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Cërrik është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për Vetëqeverisjen Vendore dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes Vendore, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Cërrik.

### **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

**Pika 1 e programit. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021.**

**Mbajtja e kontabilitetit** është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3 dhe 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 8/07/2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe i ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

-Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar me shkresë nr. 284 prot datë 30.03.2022 në Degën e Thesarit Elbasan.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë depozituar në degën e thesarit brenda afatit ligjor.

Në fund të periudhës ushtrimore 2021, janë plotësuar 8 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuar me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre në nenit 10 dhe 11 të ligjit nr., 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare.

Format nr. 1 óPozicioni Financiar.

Format nr. 2 óPerformancë Financiare.

Format nr. 3 óPasqyra e flukseve Financiare.

Format nr. 4 óPasqyra e ndryshimeve në aktivet Neto/Fondet Neto.

Format nr. 5 óPyetësor dhe shënime shpjeguese (katër flet).

Format nr. 5 óPasqyra e Lëvizjes në Cash.

Format nr. 6 óInvestimet dhe burimet financiare.

Format nr. 7/a ó Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve Afatgjata (Kosto Historike).

Format nr. 7/b ó Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto).

Format nr. 8 ó Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave.

*Bashkia Çërrrik nuk ka njësi të vartësisë.*

Per periudhën ushtrimore 2021, janë kryer rakordimet me Thesarin për të ardhurat, Shpenzimet, detyrimet dhe me treguesit që kanë të bëjnë me pasqyrat Financiare të vitit 2021.

*-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.*

*Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.*

***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program Excel.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë

kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### ***Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.***

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

*Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve

Nga verifikimi i pasqyrave të pozicionit financiar (bilancit kontabël) të vitit 2021 rezultoi: Në formatin nr. 1 për *ōAktive afatshkurtraō* gjendja në fund të vitit 2020 është 244,364,911 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 353,101,446lekë ose me shtesë në vlerën 108,736,535 lekë.

Këto aktive afatshkurtra kanë si element llogarinë 520 Disponibilitete në Thesar në vlerat 50,704,160.96 lekë në 2020 dhe 64,996,986.97 lekë në 2021 të rakorduara me Pasqyrat e Flukseve Monetare (Cash Flo ) me zërin *ōTeprica e likujdimeve në fund të vitit ushtrimorō* me vlerat përkatëse 50,704,160 lekë në vitin 2020 dhe 64,996,986 lekë në vitin 2021.

Llogaria 520 *ōDisponibilitete në Thesarō* ka si kundërparti llogarinë 85: *ōRezultati i Veprimtarisë Ushtrimoreō*.

### **Pasqyra e pozicionit financiar (F1**

#### **1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujalentet e tyre” përbëhet nga:**

Llog.Kontabel	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti i 2020
<b>I.</b>	<b>I.Mjete monetare dhe ekujalentet të tyre</b>	<b>64,996,986</b>	<b>50,704,160</b>
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke		
<b>520</b>	<b>Disponibilitete ne Thesar</b>	<b>64,996,986</b>	<b>50,704,160</b>
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provojnëzhvlerësimi letra me vlere (-)		

Vlera *ellogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”* me gjendje në çelje po ashtu edhe në mbyllje evidentohet me ndryshime me një rritje prej 14,292,826 lekë dhe përfaqëson 5% garanci për

kryerje punimesh sipas kontratave, gjë që tregon mbyllje të kontratave të punimeve dhe marrjen në dorëzim të objekteve përkatës për vlerën e mësipërme.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

## 2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020
<b>Klasa 3</b>	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>19,847,575</b>	<b>17,549,889</b>
31	Materiale	3,642,656	1,862,908
32	Inventar i imët	16,204,918	15,686,981
	<b>Totali</b>	<b>19,847,575</b>	<b>17,549,889</b>

-Llogaritë e Klasës 3, sikurse evidentohen në pasqyrat financiare me datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën 19,847,575 lekë që përbëhet nga llogaria kontabël 31 ÷Materiale në vlerën 3,642,656 lekë, dhe llogaria kontabël 32 ÷Inventar i imët në vlerën 16,204,918 lekë.

Llogaria inventariale 31 ÷Materiale në vlerën 3,642,656 lekë, pasqyrojnë gjendjen e materialeve sipas inventarëve fizik e kontabël me datë 31.12.2021, ku vlera -2,297,686 (efekti në shpenzime) është pasqyruar në llogarinë 73 ÷Ndryshime të gjendjes së inventarit të produkteve ÷ është përfshirë dhe në llogarinë 63 ÷Ndryshimi i gjendjes së inventarit, së bashku me llogarinë 32 ÷Inventar i imët në vlerën 16,204,918 lekë për vitin 2021 nga 15,686,981 lekë për vitin 2020, me një diferencë pakësim 2,297,686 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 ÷Ndryshimi i gjendjeve të inventarit dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 ÷Ndryshimi i gjendjeve të inventarit.

### 3. Llogaritë e Klasës 4 ÷Llogari të arkëtueshme

Në këtë grup të llogarive të arkëtueshme bëjnë pjesë llogaritë 465, ÷Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë në shumat 292,010 lekë në 2020 dhe 240,470 lekë në 2021. Llogaria 468, ÷Debitor të ndryshëm në vlerat 18,370,582 lekë në 2020 dhe 73,028,851 lekë në 2021 si dhe llogaria 4342 ÷Operacione me shtetin (të drejta) në vlerat 45,640,557 lekë për vitin 2020, dhe 23,197,043 lekë në 2021.

Llogaria 4342 ka sikundra parti në pasivin e Bilancit Llogarit si më poshtë:

Llogarit 42 ÷detyrimet për personelin

Llogaria 431 ÷Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksash

Llogaria 435 ÷Sigurimet Shoqërore

Llogaria 436 ÷Sigurimet Shëndetësore

Llogaria 401 ÷Furnitor e llogari të lidhura me to.

<b>Llogaria 434/2 = 23,197,043 lekë përbëhet:</b>		
Llogaria 42	9,758,260	lekë
Llogaria 431	539,143	lekë
Llogaria 435	2,923,756	lekë
Llogaria 436	405,741	lekë
Llogaria 401	9,543,143	lekë

## 1. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”

### Testet substanciale

Gjatë vitit 2021 balanca e kësaj llogarie rezulton në vlerën 73,269,321 lekë me analitik

- Gjoha dhe zhëmtime në shumën 16,184,251 lekë
- Tatime të pa paguara 51,844,600 lekë.
- Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë 240,470 lekë.

- Gjoha të IKMT 5,000,000 lekë.

Bazuar në Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare”, njohja fillestare e gjobave dhe kamatëvonesave sjell debitimin e llogarisë 468 ÷ Debitorë të ndryshëm dhe nga ana tjetër kreditimin e llogarisë 475 ÷ Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhës” për të njëjtën shumë 73,028,851 lekë. Kjo llogari kreditohet edhe për shumën e pasqyruar në llogarinë 465 ÷ Efecte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë në vlerën 240,470 lekë. Totali i llogarisë 475 është 73,269,321 lekë.

Nga ana tjetër, duke rakorduar me Inspektoriatin Vendor i Mbrojtjes së Territorit dhe me njoftimet e protokolluara në Bashkinë Cërrik së bashku me procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes ÷ Ndërtim pa leje, janë marrë vendime nga kryeinspektori i IMTV për masa administrative (gjobë) në shumën 5,000,000 lekë, nga e cila vitit 2017 në shumën 500,000 lekë, vitin 2019 në shumën 3,000,000 lekë dhe në vitin 2020 në shumën 1,500,000 lekë, duke mos arkëtuar asnjë vlerë.

Këto shuma nuk rezultojnë të regjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 ÷ Debitorë të ndryshëm dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare ÷ 7115 ÷ Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime. Pra kemi një vlerësim të llogarisë 468 ÷ Debitorë të ndryshëm dhe llogarisë ÷ 7115 ÷ Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime me 5,000,000 lekë për vitin 2021.

#### **4. Llogari të Pagueshme**

**Llogaria 467** ÷ Kreditorë të ndryshëm në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 111,807,712 lekë dhe në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 171,790,520 lekë, analitikisht të përbëra nga:

a) Shpenzimet për vendimet gjyqësore, në shumën 426,000 lekë, me kundra parti llogarinë 15 ÷ Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime.

b) Shpenzimet për kreditorët (furnitorët për mallra e shërbime) llogaria 401 me vlerë 9,117,143 lekë.

c) Shpenzimet për kreditorët (furnitorët për Investime) llogaria 408 me vlerë 171,790,520 lekë

**Llogaria 401– 408** ÷ Furnitorë e llogari të lidhura me toë në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 111,807,712 lekë dhe në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 171,790,520 lekë, pra ka një rritje prej 59,982,808 lekësh.

Këto vlera janë paraqitur dhe në mënyrë analitike nga Drejtoria e Financës të cilat përbëhen nga fatura të palikujduara gjatë dhe përpara vitit 2021.

#### **Testet substanciale**

a- Analiza e llogarive 467 ÷ Kreditorë të ndryshëm dhe 401 ó 408 ÷ Furnitorë e llogari të lidhura me toë për vitin 2021 ka vijuar si më poshtë:

Kreditimi i llogarisë 467 ÷ Kreditorë të ndryshëm për vitin 2021 ka ardhur rezultat i debitimit të kundërpartisë 486 ÷ Shpenzime të periudhave të ardhshme për vlerën 171,790,520 lekë.

Pra në mënyrë analitike llogaria 467 ÷ kreditorë të ndryshëm ka vlerat 171,790,520 lekë.

Duhet thënë se kjo llogari, është vlerësuar duke njohur detyrimet që lindin nga fatura të cilat janë të pa likujduara deri në fund të vitit 2021. Në mënyrë analitike paraqiten në **Aneksin nr.1** bashkëlidhur.

**Gjendja e llogarisë 4342** ÷ Të tjera operatione me shtetin (të drejta) ÷ në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 23,197,043 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021, që trashëgohen në vitin 2022. Kjo gjendje në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 ÷ Detyrime ndaj personelit për vlerën 9,785,260 lekë, llog.431 ÷ Detyrime ndaj shtetit për tatim taksao për vlerën 539,143 lekë, llog.435 ÷ Sigurime shoqërore për vlerën 2,923,756 lekë, llog.436 ÷ Sigurime shëndetësore për vlerën 405,741 lekë dhe vlera 9,543,143 lekë, e cila sipas verifikimeve është pjesë e detyrimeve gjendje e llog.467 ÷ Kreditorë të ndryshëm.



## **5. Të tjera aktive afatshkurtra**

**1. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 111,807,712 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 171,790,520 lekë ose me rritje në vlerën 59,982,808 lekë. Kjo llogari ka në përbërje të saj detyrimet e prapambetura ku analitikisht paraqiten si më poshtë:

<b>Llogaria 486 Shpenzime te periudhave të Ardhshme = 181,333,663 lekë: Përbëhet</b>	
Shpenzime per v.gjyqsore	426,000
Shpenzime per Furnitor 401	9,117,143
Shpenzime për Furnitor 404	171,790,520

### **Testi substancial**

Referuar dhe analizës së mësipërme të llogarive 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2021 siç u përmendën dhe më lart, llogaria 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhet të ketë kundërparti llogarinë 467 ÷Kreditorë të ndryshëm, e cila nga ana e saj është vlerësuar drejtë me vlerë 171,790,520 lekë për vitin ushtrimor 2021.

Ndërsa llogaria 520-Disponibilitete në Thesar përfaqëson vlera të depozituara dhe të trashëguara nga vitet e mëparshme.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Më poshtë po paraqesim testet substanciale në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura të periudhës ushtrimore 01.01.2021 - 31.12.2021.

*Më poshtë po paraqesim testet substanciale në lidhje me llogaritë të cilat janë vlerësuar si materiale, bazuar në materialitetit e përcaktuar, dhe që përbëjnë një evidencë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare të mbyllura të vitit 2021*

## **6. Aktivët Afatgjatë materiale**

**Në lekë**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020
21	<b>2.Aktive Afatgjatë materiale</b>	<b>1,354,686,083</b>	<b>1,732,534,145</b>
210	Toka, Troje, Terrene	5,655,845	5,655,845
211	Pyje, Plantacione	1,692,300	1,692,300
212	Ndertesa e Konstruksione	738,912,302	768,150,848
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	547,233,813	928,249,589
214	Instalime teknike, makineri e paisje	31,418,603	25,060,290
215	Mjete Transporti	16,238,793	2,737,992
218	Inventar ekonomik	13,534,427	987,281

**Llog 210 “Toka, troje terrene”** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrrik dhe për 4 ish Komunat, në fund të vitit 2020 dhe 2021 rezultonin në vlerën 5,655,845 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)ö si në mbyllje të vitit 2019 dhe në mbyllje të vitit 2020 në të njëjtën vlerë.

### **Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2021**

	EMËRTIMI	31.12.2020	Shtesa	Pakësime	31.12.2021
1	TOKA, TROJE E TERRENE	<b>5,655,845</b>	-	-	<b>5,655,845</b>
2	Troje	2,737,436	-	-	2,737,436
3	Tokë bujqësore	0	-	-	0
4	Terrene të shtresave	300,000	-	-	300,000
5	Sistemime dhe rregullime të tokave	0	-	-	0
6	Të tjera	1,748,940	-	-	1,748,940
7	Troje sheshe Mollas	300,000	-	-	300,000
8	Troje Qendra e Grumbullimit	569,469	-	-	569,469

**Llog 210 “Toka ,Troje, Terrene** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrik dhe për 4 ish Komunat, sipas Formatit nr.7/B òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 5,655,845 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 5,655,845 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

**Titulli gjetjes 1:***Mbi kontabilizimet në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 5,655,845lekë gjendje e cila nuk është e analizuar.*

**Situata:**

**Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,655,845lekë. Për këtë gjendje llogarie të palëvizshme nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.Mungesa e analizës për vlerën 5,655,845 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

**Kriteri:**

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

**Impakti:**

Mungesa e analizës për vlerën 5,655,845 lekë që i përket llog.210 òToka, Troje, Terreneò ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:**

Nga Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

**Rëndësia:***I lartë*

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Titulli gjetjes 2:***Mbi kontabilizimet në llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 1,692,300 lekë gjendje e cila nuk është e analizuar.*

**Situata:**

**Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,692,300 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,692,300 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për vlerën 1,692,300 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

**Kriteri:**

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

**Impakti:**

Mungesa e analizës për vlerën 4,662,464 lekë që i përket llog.211 Pyje, Plantacione me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:**

Nga Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacionin financiar i trashëguar në vite me qëllim evidentimin e vlerësimit të gjendjes aktuale dhe statusin e pyjeve e plantacioneve sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Cërrik, shtojca nr.14, të transferuara me VKM nr.433 datë 08.06.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive”.

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të transferuar për nxjerrjen e të dhënave për veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësisht e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**-Llog. 212 “Ndërtime e konstruksione”,** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrik dhe për 4 ish Komunitat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 768,150,848 lekë dhe fund të vitit 2021 për vlerën 738,912,302 lekë, ose me zvogëlim në shumën 29,238,546 nga e cila; 59,533,491 lekë janë rikonstruksione; objekte arsimore, godina administrative dhe qendra shëndetësore të njësisive të ndryshme, ose me zvogëlim në vlerën neto 29,238,546 lekë për shkak të amortizimit të akumuluar.

Teprica në fillim 2020			Shtesat gjatë vitit Blerje		Teprica në Fund 2021		
Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike	Akumuluar	Neto
865,014,702	96,863,854	768,150,848	59,533,491	88,772,037	924,548,193	185,635,891	738,912,302

**Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”,** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrik dhe për 4 ish Komunitat, në fund të vitit 2020 për vlerën neto 928,249,589 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 547,233,813 lekë. Shtesa gjatë vitit 2021 paraqitet në

vlerën 40,703,459 lekë e cila përbëhet nga rikonstrukcion i rrjeteve dhe me zvogëlim në vlerën neto 851,387,850 lekë për shkak të amortizimit të akumuluar.

Teprica në fillim 2021			Shtesat gjatë vitit blerje		Teprica në Fund 2021		
Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike	Akumuluar	Neto
1,357,918,204	429,668,615	928,249,589	40,703,459	421,719,235	1,398,621,663	851,387,850	547,233,813

**-Llog. 214 “Instalime teknike, makineri e paisje”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrrik dhe për 4 ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën neto 25,060,290 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 31,418,603 lekë ose me rritje në vlerën neto 6,358,313 lekë. Rritja ka ardhur për shkak të shpenzimeve të kryera gjatë vitit si vijon; Mjete dhe paisje të tjera teknike në vlerë 4,984,900 lekë.

Teprica në fillim 2021			Shtesat gjatë vitit blerje		Teprica në Fund 2021		
Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike	Akumuluar	Neto
47,010,961	21,950,401	25,060,290	4,984,900	1,373,413	51,995,591	20,576,988	31,418,603

**-Llog. 215 “Mjete transporti”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrrik dhe për 4 ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën Neto 2,737,992 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 16,238,793 lekë ose me rritje në vlerën neto 13,500,801 lekë. Rritja ka ardhur për shkak të shpenzimeve të kryera gjatë vitit si vijon; mjete transporti në vlerë 6,233,360 lekë.

Teprica në fillim 2021			Shtesat gjatë vitit blerje		Teprica në Fund 2021		
Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike	Akumuluar	Neto
50,662,635	47,924,643	2,737,992	6,233,360	7,277,441	56,885,995	40,647,202	16,238,793

**Llog. 218 “Inventar Ekonomik”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Cërrrik dhe për 4 ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerë neto 3,424,556 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 5,713,490 lekë ose me rritje në vlerën neto 2,288,934 lekë. Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e plogjionit financiar 2021, është marrë neto. Ulja e vlerave nga viti në vit ka ardhur për shkak të rritjes së normës së amortizimit. Vlera e aktiveve sipas llogarive është e regjistruar në një regjistër kontabël ku specifikohen në mënyrë analitike sipas llogarive kontabël.

-Në regjistrin kontabël nuk ka informacion të saktë lidhur me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, datën e daljes në përdorim, kohën e shërbimeve e të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, datë e skadencës, kontabël.

*Ka shumë aktive të inventarizuara por të pa vlerësuara për vitin 2021.*

-Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31, ku citohet se:

“Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre.”

## Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Cërrik

Gjatë vitit 2021, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.310 datë 2.12.2021 për ngritjen e komisionit të inventarizimit të elementëve të pasurisë së Bashkisë Cërrik, përfshirë këtu dhe 4 njësitë administrative (Shalës, Gostim, Klos dhe Mollas) për vitin 2021.

Si dhe urdhri nr.311 datë 02.12.2021 për ngritjen e komisionit të inventarizimit të Aseteve të Bashkisë Cërrik, përfshirë këtu dhe 4 njësitë administrative (Shalës, Gostim, Klos dhe Mollas) për vitin 2021.

Per Vitin 2021 Komisioni I Inventarizimit ka kryer Inventarizim e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim, si dhe Aktivet afatshkurtra jo financiare, Inventar i imët të stokuar në Administratë dhe në Institucionet në vartësi të Bashkisë Cërrik.

Komisioni pasi ka inventarizuar gjendjen e Aktiveve afatgjata në qarkullim dhe Inventarin e imët, ka propozuar; nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve objekt Inventari dhe inventarin e imët, të cilat kanë humbur funksionin dhe kanë mbushur afatet e normuaratë përdorimit, sipas përcaktimeve të paragrafeve, 107, 108, 109 të udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011 të Ministrit të Financave.

Komisioni me proces-verbal të datës 07/01/2022 ka identifikuar materiale për nxjerrje jashtë përdorimit për inventarët e imët (llogaria 327 Inventar i imët), llogaria 218 Inventari ekonomik si dhe llogarinë 214 Instalime teknike makineri e pajisje, për të cilat është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.310/1 datë 11.01.2022 për ngritjen e komisionit të vlerësimit të materialeve objekt inventari të cilat janë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Komisioni me Process-Verbal datë 24/01/2022, ka verifikuar gjendjen e këtyre materialeve dhe ka propozuar; Nxjerrjen jashtë përdorimit të Inventarit të imët, materialet objekt Inventari, të cilat kanë humbur funksionin dhe kanë mbushur afatet e normuara të përdorimit, Sipas përcaktimeve të paragrafeve, 107, 108, 109 të udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011 të Ministrit të Financave.

Komisioni ka përgatitur materialin dhe ka depozituar në drejtorinë e financës. Nëpunësi Zbatues ka përgatitur Relacionin dhe ka paraqitur bashkë me projekt vendimin në këshillin bashkiak për miratim.

- **Llogaria 218** Pajisje elektronike dhe Pajisje zyre të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,317,176 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto)

- **Llogaria 327** inventar i imët të dala jashtë përdorimit në vlerën 177,189 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto) në lekë.

FLETËN INVENTARIZIM PËR MALLRA, MATERIALE E INVENTARIT TË IMËT Llogaria 218												
Nr	EMËRTIMI	Njësia	Çmimi	Sipastëdhënave kontabël		Sipastëdhënave Inventarizimit		REZULTATET				Vërejtje Për lëvizjet
				Sasi	Vlefte	Sasi	Vlefte	Mungesat		Propozohen jashtë/p		
								Sasi	Vlefte	Sasi	Vlefte	
1	ADMINISTRATACERRIK		34,288,418		34,288,418		34,202,578				85,840	
2	NJAGOSTIME		16,749,566	1	16,749,566	1	16,606,686				142,880	
3	Uji		1,295,008		1,295,008		1,295,008					
4	NJAMOLLAS		10,661,361		10,661,361		10,501,200				160,161	
5	NJA KLOS		3,374,582		3,374,582		3,362,782				11,800	
6	NJASHALES		7,250,136		7,250,136		6,333,641				916,495	
7	MAGAZINE				<b>73,619,074</b>		<b>72,301,898</b>				<b>1,317,176</b>	

FLETËN INVENTARIZIM PËR MALLRA, MATERIALE E INVENTARIT TË IMËT Llogaria 327												
Nr	EMËRTIMI	Njësia	Çmimi	Sipastëdhënave kontabël		Sipastëdhënave Inventarizimit		REZULTATET				Vërejtje Për lëvizjet
				Sasi	Vlefte	Sasi	Vlefte	Mungesat		Propozohen jashtë/p		
								Sasi	Vlefte	Sasi	Vlefte	
1	ADMINISTRATACERRIK	cop	5,480,753		5,480,753		5,418,523				<b>62,230</b>	
2	NJAGOSTIME		6,172,439	1	6,172,439	1	6,167,815			1	4,624	
3	Uji		110,710	1	110,710	1	110,710					
4	NJAMOLLAS		1,383,319		1,383,319	1	1,381,319				2,000	
5	NJA KLOS		359,105		359,105	1	345,681				13,424	
6	NJASHALES		2,511,169		2,511,169		2,416,257				94,911	
7	MAGAZINE											
	<b>SHUMA</b>				<b>1,601,7497</b>		<b>1,584,307</b>				<b>177,189</b>	

-Procesi Inventarizimit është mbyllur dhe është në fazën e miratimit në Këshillin Bashkiak. Në të gjitha rastet, urdhrat janë përpiluar për materialet, inventarët i imët, inventarin ekonomik si dhe inventarizimin e Aseteve të Bashkisë, përkatësisht në llogaritë ekonomike si më poshtë:

210 Toka, troje, terrene;

212 Ndërtesa e Konstruksione;

213 Rrugë, rrjete, vepra ujore;

214 Instalime teknike, makineri e paisje;

215 Mjete transporti;

Aktivitet afatshkurtra;

Veprimet e mësipërme janë bërë në përputhje me;

Ligjin 10296 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko pikat nga 26-30, si dhe pikën 74.

Në Bashkinë Cërrrik, në vitin 2020 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, **210 “Toka, troje, terrene”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 Instalime teknike, makineri e paisje, 215 “Mjete transporti “.**

**Për llogaritë ekonomike; 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 214 Instalime teknike, makineri e paisje, 215 “Mjete transporti “** nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

**Titulli gjetjes 3: Mbi mbajtjen e regjistrit historik të aktiveve dhe llogaritjen e amortizimit të AAGJ.**

### **Situata:**

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2020 është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivitet. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim gjendje në fund të vitit 2020 janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivitet brenda llojit, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktivitet. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktivitet me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezultoi se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivitet sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivitet në total dhe jo aktivitet për aktivitet, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktivitet të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktivitet u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktivitet të veçanta në llogaritë të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.

### **Kriteri:**

UMF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

**Impakti:**

Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos òcertifikuarò vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

**Shkaku:**

Nga Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të Aktiveve në qarkullim, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.

**Rëndësia : I lartë**

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

**Aktive Afatgjata jo materiale**

**Testi substancial**

Për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021, të cilat janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël të vitit 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuaduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë.

Analitikisht ***Ilogaria 202 “Studime dhe kërkimeò*** për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Nr	Projekti	Furnitori	Fletë Hyrje			Urdhër Shpenzim		
			Nr	Datë	Shuma	Nr	Datë	Shuma
1	Projekt me Lote B.Cerrik Rikualifikim urban	N...	10	10.12.2019	170,388	579	22.12.2021	170,388
2	Projekt òndertim Lapidari Dumreseò	N...	103/1	20.12.2019	117,117	578	20.12.2021	723,000
3	Projekt Rikonstruksion i rrugës Licaj	Z...	74	22.12.2020	817,692	51	08.02.2021	817,692
4	Projektim për linja KUZ B. Cërrik	L.K.	18	17.05.2021	72,000	268	08.06.2021	72,000
5	Projekt Rikonstruksion e 23 banesave	G....	32	20.10.2021	120,000	484	26.10.2021	120,000
6	Projekt Ndërtim ujësjellsi Klos, Selvias	Z...	43	20.12.2021	7,911,972	608	24.12.2021	2,000,000
7	Hartim I planeve të rilevimit të 65 apartamenteve	M....	45	30.12.2021	78,000	322	23.06.2020	146,592
<b>Shuma</b>					<b>9,287,169</b>	<b>Diferencë 5,989,972</b>	<b>3,297,197</b>	

**Titulli gjetjes 4:** *Nënvlerësimi i llogarisë 202 Studime dhe kërkime dhe moskapitalizimi i tyre në kostot e aktiveve afatgjata materiale pasi është marrë në dorëzim investimi përkatës.*

### **Situata:**

Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se: Për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021. Dhe janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuaduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë.

### **Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare nëni 6,9 dhe 10, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, pika 6c.

**Shkaku:** Mos njohja e situatës në lidhje me projektet e zbatuara.

**Rëndësia:** E Mesme

### **Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 2021 *Studime e projekteve*, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972.

Të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit dhe të paraqiten në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022.

## **3. Aktive Afatgjata Financiare**

### **Testet substancial**

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2020 janë në vlerën 79,086,846 lekë dhe në fund të vitit 2021 këto aktive janë rritur me 280,000 lekë që i përkasin aksioneve të Bashkisë Cërrik në kompaninë "E....." Sha. Krijuar me akt-themelimi nr.4656/2 prot. datë 16.11.2021.

Si rrjedhojë, Aktivet Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2021 në vlerën 79,366,846 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2021 është paraqitur në vlerën 79,366,846 lekë, siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më sipër. (rreshti 59)

Bashkia Cërrik, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 16/11/2021 paraqitet si aksionere me 0.125% të aksioneve të "E....." me NUIS "M....." Të e cila është shoqëri aksionere me objekt "Grumbullimi dhe përpunimi mbetjeve Urbane.

Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Kjo vlerë e kapitalit, aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Cërrik në "U....." Sh.A.100% dhe "E....." Sha.0.125, paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në përputhje me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".



Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 79,366,846 lekë ku investori është Bashkia Cërrrik.

Llogaria 26 Pjesemarrje në kapitalin e vetë					Në/lekë
Nr.		Akti Themelimit	Aksione	Ne %	Vlera
1	U.....	29/08/2020	1	100	79,086,846
2	L.....	18/11/2021	0.125	8	280,000
	<b>SHUMA</b>				<b>79,366,846</b>

### Llogaria 230 dhe 231 "Investime" Për aktive afatgjata materiale

Për periudhën 2021 nga analiza e kësaj llogarie, Investimet në poqes krahasuar me vitin 2020 janë rritur nga 270,114,000 lekë në 510,044,801lekë, me një rritje prej 239,930,800 lekë. Kjo rritje e shpenzimeve për Investime ka ardhur si rezultat i likujdimit të detyrimeve për Angazhimet, 3-Vjecare që ka ndërmarrë Bashkia, ku peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për Ujësjiellësin Mollas me 185,000,000 lekë dhe Investimi për përmirësimin e kushteve të banimit me 24,231,205 lekë të cilat janë Investime të financuara nga Qeveria Shqiptare të planifikuara për 3 vite. Pjesa tjetër janë Investime të vetë Bashkisë për angazhime të planifikuara për 3 vite.

Mungesa e fondeve ka bërë që këto projekte të mos likujdohen e si pasojë mos të kontabilizohen gjatë periudhës raportuese.

Kjo situatë ka mbi ngarkuar llogarinë 486 për detyrimet e prapambetura krahasuar me vitin 2020, me 59,982,808 lekë dhe shtuar kreditorët, në llogarinë 467 me 59,982,808 lekë.

Më poshtë paraqitet pasqyra e ecurisë së llogarisë 231 për vitet 2020-2021. Nga tabela duket qartë se rritja e shpenzimeve për Investime është shoqëruar me rritjen e kapitalizimeve, nga 27,989,848 lekë të kapitalizuar në 2020, në 66,169,067 lekë në vitin 2021, me një rritje prej 38,179,219 lekë. Tabela paraqitet bashkëlidhur materialit në “Aneksin” nr.2

Në lekë

Nr	EMËRTIMI	Teprica në fillim të Vitit	Transaksionet e vitit		Në fund
			Debi	Kredi	
I.	SHPENZIMET PËR INVESTIME	349,200,487	31,287,045	271,497,845	<b>589,411,647</b>
230	Shpenzime për AAJM		3,297,197	3,297,197	<b>0</b>
231	Shpenzime për AAM	270,114,001	27,989,848	267,920,648	<b>510,044,801</b>

Për investimet e kryera gjatë vitit 2020, është debituar në llogarinë 231 dhe është kredituar në llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata". Në mënyrë analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në **“Aneksin nr. 2** bashkëlidhur. Ndërsa shpenzimet për investime në proces të cilat i përkasin projekteve të ndryshme në vlerë 510,044,801 lekë dhe paraqiten në *Aneksin nr.3/2* bashkëlidhur.

**C. AKTIVET neto/fondet (A-B) në fund të vitit 2020 evidentohet në vlerën 2,140,672,480 lekë, me një vlerë të barabartë me klasën D “Fondi i Konsoliduar”.**

**D. “FONDI I KONSOLIDUAR”, në fund të vitit 2020 evidentohet në vlerën 2,140,672,480 dhe paraqitet si më poshtë:**

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>2,140,672,480</b>	<b>2,140,672,480</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,849,477,588	2,019,041,056
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	64,996,986	38,119,107

Llog.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve	25,629,677	2,999,471
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime	426,000	1,426,000
105	Teprica e Granteve kapitale Të Brendshme	79,366,846	79,086,846
106	Teprica e Granteve kapitale Të Huaja	1,921,080	-
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	-	-
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE (B+C)</b>	<b>2,302,912,666</b>	<b>2,329,524,459</b>

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë vitit ushtrimor" evidentohet me suficit në vlerën **64,996,986 lekë**, sikurse evidentohet edhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Në Pasqyrën e Flukseve Monetare, evidenton likuiditetet dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nga kontrolltet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në vlerën **64,996,986 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Llogaritë Financiare (Disponilitete në Thesar)" e cila paraqitet në vlerën **64,996,986 lekë**. Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në zbatim me kërkesat e përcaktuara në **UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare"**.

**Pasqyra e Performancës financiare (F2)** Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Cërrrik më datë 31.12.2020 janë të rakorduara me Degën e Thesarit Elbasan, konkretisht:

Llog	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>560,175,442</b>	<b>520,207,366</b>
720	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>560,175,442</b>	<b>520,207,366</b>
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendore)	336,106,577	343,768,843
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	180,483,552	130,408,446
7202	Nga Buxheti per pagesa te posaçme te ISSH		-
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		-
7204	Pjesmarrije e institucioneve ne tatime nacionale	8,092,851	-
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		-
7206	Financim I pritshe nga buxheti	23,197,043	45,640,557
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	12,295,419	389,520
7209	Te tjera grante korente te brendshme		-

**Pasqyra e Flukseve Monetare (CASH FLOW), Formatit nr. 3**

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi akordimin e fondeve buxhetore për shpenzime korente, për detyrime e shpenzime korente, për shpenzimet kapitale (investimet), transfertat, rritja/rënia neto e mjeteve monetare, si dhe tepricat e likuiditeteve në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor, përmbledhtazi si më poshtë:

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	41,038,335	22,919,255
1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	<b>535,905,036</b>	<b>519,507,347</b>
	Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	66,842,974	72,795,886
	Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	33,601,849	24,259,370
	Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	12,295,419	389,520
	Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	2,219,200	4,256,837
	Te tjera, arketuar(+)	8,094,720	
	Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	<b>94,865,529</b>	- <b>595,592,092</b>
	Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	2,219,200	- 2,697,613

Nr	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	7,756,603	- 7,666,832
	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	300,536,339	181,528,703
	Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)	1,104,122	
	Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	9,372,559	- 77,717,260
	Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	300,024,505	- 110,522,880
	Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		- 955,395
III	TRANSFERTA E TE TJERA	6,403,852	- 2,866,219
	Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	134,038	- 12,601
	Transferime ne buxhet te Fondeve të pa perdorura(-)	6,269,814	- 7,353,618
	Lëvizje e brendshme e transferata te tjera(+)		4,500,000
IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	26,877,880	12,386,204
V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	38,119,107	38,317,957
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	64,996,987	50,704,161

V.O. Në tabelë nuk janë përfshirë rubrikat boshe

**Për llogaritë ekonomike; 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 214 Instalime teknike, makineri e paisje, 215 “Mjete transporti “** nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.

2. Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale -Për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021. Dhe janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuiduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë.

-Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të trupëzuara është llogaritur sipas normave të amortizimit të përcaktuara udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 36. Në kontabilitet, ai është pasqyruar në pasiv të bilancit si fond dhe në aktiv si pakësim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e rakorduar kjo shumë, me formatin 7 të pasqyrës së bilancit.

U konstatua se ishin mbajtur ditarët e Pagesave, ditari i Bankës dhe Magazinës, Libri i magazinës, por nuk është mbajtur Ditari i Veprimeve të ndryshme dhe Centrilitator.

Ditari i Bankës, në këtë ditar reflektoheshin llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe të gjithë llogaritë, sipas planit kontabël bazuar në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

Kështu, mund të përmendim faktin se prekeshin llogaritë në fillim të vitit ushtrimor: Debi 520 ÷ Disponibilitete në Thesarë dhe në fund të vitit ushtrimor, për përdorimin e fondeve buxhetore korrente dhe kapitale, sipas situacionit të rakorduar me thesarin, bëheshin veprimet me llog. 720 ÷ Grant korrent i brendshëm; 105 ÷ Teprica e granteve kapitale të brendshme dhe 4342 ÷ Operacione me shtetin (të drejta) ÷. Po kështu për të gjithë llogaritë e tjera veç atyre financiare dhe të shfrytëzimit.

Lidhur me ditarin e llogarive të magazinës, për Aktivet Qarkulluese, konstatohet se veprimet dhe ngjarjet e ndodhura, janë marrë në ditar dhe janë kontabilizuar si llogaria 63 ÷ Ndryshimi i gjendjeve ÷ e cila prekej vetëm në ÷ Debi ÷ për fletë-daljet, ndërsa për fletë-hyrjet prekej në ÷ Kredi ÷ llogaria 401 ÷ Furnitorë, në një kohë që kjo llogari ka lidhje dhe kreditohet në debi të llogarisë së klasës 6 të shpenzimeve të shfrytëzimit.

Kontabilizimi i llogarisë 63 në debi, bëhej për çdo fletë dalje.

Sa më sipër është në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Pasqyrat financiare të vitit 2021, ishin hartuar bazuar në Ditarin e Bankës dhe të Magazinës, Inventarëve dhe shumë veprime për nxjerrjen e Pasqyrave Financiare janë bazuar me regjistrimin kontabël të aktiveve.

Për artikujt e magazinës dhe për të gjithë postet e tjera të pasqyrave financiare, ishin përgatitur inventarët dhe analizat sipas këtyre posteve, në zbatim të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ÷ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, si dhe në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, ku përcaktohet se:

÷ Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet m vete), para evidentimit të të dhënave në pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore.

Të dhënat për amortizimin janë nxjerrë nga ditarët e kontabilitetit ku janë të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore, si dhe në pasqyrën e performancës financiare Rubrika 7.

Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky në moszbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31, ku citohet se:

÷ Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre.

Për këto AAGJM, na u paraqitën dokumente analitike dhe inventar kontabël e fizik dhe mbahen gjithashtu në pasqyrën financiare vjetore në Aktiv, si shuma të analizuar.

Llogaria kontabël 218 ÷ Inventar ekonomik është evidentuar në bilanc më vete por gjithashtu është paraqitur më vete dhe llogaritë 214 ÷ Instalime elektrike, makineri e paisje, Llogaria 215 ÷ Mjete transporti, Llogaria kontabël 24 ÷ Aktive afatgjata të dëmtuara, Llogaria kontabël 28 ÷ Caktime të aktiveve afatgjata në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se gjendja e llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,655,845 lekë, i pandryshuar. Për këtë gjendje llogarie të palëvizshme nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Gjendja e llog. 211 “*Pyje, Plantacione*”, paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,692,300 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”*, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,692,300 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-31 të Raport Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Cërrrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe llog. 211 “*Pyje, Plantacione*”, ku nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësisht e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Brenda datës 31.12.2022**

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale në qarkullim (në vlerën bruto) për vitin 2021 është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale në qarkullim gjendje në fund të vitit 2021 janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të amortizimit të AAGJ materiale në qarkullim, rezulton se përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit, duke aplikuar normat ligjore të amortizimit. Por konstatohet se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përlllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistrimit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përlllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 5, dat 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-31 të Raport Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike Bashkia Cërrrik, të hartojë një

regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre e ekzistencës fizike.

**Brenda datës 31.12.2022**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se për vitin 2021, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, rezultojnë se 7 projekte me kosto historike 9,287,169 lekë, të bëra hyrje në vitin 2019, 2020 dhe 2021, të cilat janë kapitalizuar në bilancin 2021 me kosto historike 3,297,197 lekë. Nuk është njohur në bilancin kontabël të vitit 2021 vlera 5,989,972 lekë dhe kjo ka ndodhur pasi projekti për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Klos, Selvias nuk është likuiduar gjatë vitit 2021, në fakt është marrë në dorëzim dhe duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 5,989,972 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare në neni 6,9 dhe 10, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, pika 6.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-31 të Raport Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Cërrik, të marrë masa për sistemimin e llog. 202 të Studimeve e projekteve, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972 lekë.

Të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

## V. ANEKSE

Aneksët janë pjesë përbërëse e këtij Raport Auditimi:

### ANEKSI

#### Aneks Nr.2 Investimet në proces

Shpenzimet ne Proces	Llogaria 231	gjendje 2020			Detyrimet 401-408	2021 231	kapitalizimi 2021
		231	2020	2021			
Përshkrimi i Veprimit	Kodi	Debi	kredi	Shpenzime	Debi	Kredi	Debi
Gostima - Tregu		10,298,964				10,298,964	
Tjera (Platacion)		14,207,063				14,207,063	
Supervizim Rruga Linas		650,000				650,000	
Kolaudim Fidan Pyjor		58,800				58,800	

Rehabilitim i Terreneve Sportive	1100170		2,425,404		2,425,404		2,425,404
Rikualifikime Urbane	1100144	12,868,017				12868017	
Bashkefinanc.Rikonstruksione	1100170		2,745,017	716,738	3,461,755		3,461,755
Rikonstruksion Objekte Shkollore	1100198		1,958,902		1,958,902		1,958,902
Permiresim Kushte Banimi	M100397	16,780,251				16,780,251	
Terminal Autobuzi	1100148	3,678,084		2,207,720		5,885,804	
Kanale Vaditese	18AY934						
Ndriçim Rrugor	1100149	6,403,000		1,000,000		7,403,000	
Arredim e Foni per Kinemane	1100162	4,981,939				4,981,939	
Rikonst.Godine Njesia Klos	1100194		5,000,000	2,439,326	7,439,326		7,439,326
Suipervizim Godina Klos	1100202		60000	40000	100000		100,000
Rikualifik. Urbane L.2.1	1100144		3,740,524	2,000,000	5,740,524		5,740,524
Supervizim Rikualifik. Urbane L.2.1	1100202		60,000	30,000	90,000		90,000
Rikualifik. Urbane L.2, Mollas	1100144	7,160,000		5,074,602		12,234,602	
Supervizim Rikualifik. Urbane L.2, Mollas	1100202	118,000				118,000	
Rikualifikim Urban B 3,L 2 Cërrik	1100204	5,019,588		6,000,000		11,019,588	
Permirsim kushte banimi	M100397	12,204,104				12,204,104	
Permirsim kushte banimi	M100397	6,746,484				6,746,484	
Permirsim kushte banimi	M100399	10541097		2,423,1205		34,772,302	
Permirsim kushte banimi	M100397			4,160,917		4,160,917	
Reab.Kanale Stacion Pompash shtepanje	1100141	15,143,037		1,000,000		16,143,037	
Rikonst.Rruge rurale Zdrava	1100164	32,516,715		269,5085		35,211,800	
Supervizim rruge Rurale	1100202	796,107		202,400		998,507	
Kolaudim rruge Rurale	1100201	30,000		60,000		90,000	
Supervizim Rruga Xibrake	1100202	24,000		10,5600		129,600	
Kolaudim rruga Xibrake	1100201	10,000				10,000	
Rikonstruksion rruga Qyrkan	1100203	5,068,328		5,000,000		10,068,328	
Riparim Stacioni I Pompave Shelg	1100196	3,000,000		2,027,326		5,027,326	
Rikonst.Rruga Çamera	1100164	4,368,000		4,957,060		9,325,060	
KUZ	1100166	1300000		4000000		5300000	
Kanale ujitese	19AF322		12,000,000	28,451,459	40,451,459		40,451,459
Mbikqyrje kanale uites				252,000	252,000		252,000
Ujesjelles Mollas	19AF801	67,456,579		185,000,000		25,245,579	
Supevizim Ujesjelles Mollas	19AF802	695,996		1,200,000		1,895,996	
Paisje Elektronike	1100136			597,500	597,500		597,500
Paisje te Tjera	1100137			1,243,656	1,243,656		1,243,656
Pike Lidhje	1100165			91,860	91,860		91 860
Paisje Ndicim rrugor	1100192			395,600	39,5600		395 600

### ***Aneks nr.3 Të ardhurat***

<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>681,006,964</b>	<b>621,688,093</b>
<b>70</b>	<b><i>ITE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</i></b>	<b>66,842,974</b>	<b>72,795,886</b>
<b>700</b>	<b><i>1.Tatimi mbi te Ardhurat</i></b>	<b>758,444</b>	<b>360,168</b>
<b>7000</b>	<b><i>Tatim mbi te ardhurat personale</i></b>		
<b>7001</b>	<b><i>Tatim mbi Fitimin</i></b>		
<b>7002</b>	<b><i>Tatim mbi Biznesin e vogel</i></b>	<b>758,444</b>	<b>360,168</b>
<b>7009</b>	<b><i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i></b>		
<b>702</b>	<b><i>2.Tatimi mbi Pasurine</i></b>	<b>38,404,669</b>	<b>47,118,530</b>
<b>7020</b>	<b><i>Tatim mbi Pasurine e paluajtshme</i></b>	<b>38,404,669</b>	<b>47,118,530</b>
<b>7021</b>	<b><i>Tatim mbi shitjen e pasurise se paluajtshme</i></b>		
<b>7029</b>	<b><i>Te tjera tatime mbi Pasurine</i></b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>703</b>	<b><i>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</i></b>	<b>27,563,061</b>	<b>25,228,438</b>
<b>7030</b>	<b><i>Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)</i></b>		
<b>7031</b>	<b><i>Akciza</i></b>		
<b>7032</b>	<b><i>Takse mbi sherbimet specifike</i></b>		
<b>7033</b>	<b><i>Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie</i></b>	<b>12,083,295</b>	<b>10,862,236</b>
<b>7035</b>	<b><i>Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie</i></b>	<b>15,479,766</b>	<b>14,366,202</b>
<b>704</b>	<b><i>4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare</i></b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>7040</b>	<b><i>Takse doganore per mallrat e importit</i></b>		
<b>7041</b>	<b><i>Takse doganore per mallrat e eksportit</i></b>		
<b>7042</b>	<b><i>Tarife sherbimi doganor e kaliposte</i></b>		
<b>7049</b>	<b><i>Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare</i></b>		

705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare	116,800	88,750
709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
75	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOOERORE E SHENDETESORE</b>	-	-
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOOERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
71	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	33,601,849	24,259,370
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	8,398,139	6,420,379
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	8,398,139	6,420,379
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	25,082,122	17,742,413
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	20,707,489	15,502,759
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	1,223,850	834,840
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	99,000	257,000
7114	Te ardhura nga biletat	12,680	3,500
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	3,039,103	1,144,314
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	121,588	96,578
76	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	-	-
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	560,175,442	520,207,366
720	1.Grant korent I Brendshem	560,175,442	520,207,366
7200	Nga Buxheti per NJOP(Oendrore)	336,106,577	343,768,843
7201	Nga Buxheti per NJOP(Vendore)	180,483,552	130,408,446
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	8,092,851	
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti	23,197,043	45,640,557
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	12,295,419	389,520
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	2.Grant korent I Huaj	-	-
	Nga Oeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	22,684,385	4,425,471
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
785	Perdorimi I shumave te prashikuara per shpenzime te viteve te ardheshme	426,000	1,426,000
787	Terheqje nga seksioni I investimeve	22,258,385	2,999,471
73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>	(2,297,686)	

#### **Aneks nr.4 Shpenzimet**

<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>616,009,977</b>	<b>583,568,986</b>
600	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>168,608,407</b>	<b>143,620,430</b>
6001	Paga, personel I perhershem	161,377,128	138,270,990
6002	Paga personel I Perkohshem	5,051,279	5,349,440
6003	Shperblime	2,180,000	
6009	Shpenzime te tjera per personelin	-	
601	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>26,784,923</b>	<b>25,069,201</b>
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	24,060,165	22,621,714
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,724,758	2,447,487
602	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>93,217,761</b>	<b>66,740,357</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,982,930	6,801,788
6021	Materiale dhe sherbime speciale	14,419,387	12,527,134
6022	Sherbime nga te trete	28,172,313	14,754,614
6023	Shpenzime transporti	18,042,662	20,239,692
6024	Shpenzime udhetimi		-
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	13,956,572	817,414
6026	Shpenzime per qeramarrje	204,000	117,600



6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	2,709,940	1,862,576
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	4,151,990	4,502,079
6029	Shpenzime te tjera operative	9,577,967	5,117,460
<b>603</b>	<b>IV.SUBVEZIONE</b>	<b>8,288,000</b>	<b>6,758,800</b>
6030	Subvecone per diference cmimi		
6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
6032	Subvecone per te mbuluar humbjet	8,288,000	6,758,800
6033	Subvecone per siper marrjet individuale		
6039	Subvecone te tjera		
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>320,982,572</b>	<b>339,166,520</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>107,584</b>	<b>1,057,012</b>
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		877,491
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore	7,584	3,601
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	100,000	175,920
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>320,874,988</b>	<b>338,109,508</b>
6060	Transferita Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	320,874,988	338,109,508
	<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		-
<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>426,000</b>	<b>1,426,000</b>
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit	426,000	1,426,000
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>(2,297,686)</b>	<b>787,678</b>
	<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>		
<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES</b>		
	<i>(Rezultati I Veprimtarise se vitit (Ushtrimor)</i>	<b>64,996,987</b>	<b>38,119,107</b>

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT